

Vendim nr. 256 datë 21.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 21.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 28 (B) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **BLENDO (EDISON) ALIKAJ**, përfaqësuar nga avokatët Ndue Pjetra dhe Klodjan Reçi, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 234, datë 14.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 319, datë 18.07.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2025-346 (58), datë 27.02.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 30, 32, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pikat 1 dhe 2, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është akuzuar për kryerjen e veprave penale “Vrasja me dashje në rrethana të tjera cilësuese”, të mbetur në tentativë dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 79, shkronja “dh” dhe 22, si dhe 278 të Kodit Penal (KP).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 234, datë 14.05.2018, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Vrasja me dashje në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga nenet 79, shkronja “dh” dhe 22 të KP-së dhe dënimin e tij me 24 (njëzet e katër) vjet burgim. Deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së dhe dënimin e tij me 4 (katër) vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve, dënimin e kërkuesit me një dënim të vetëm prej 24 (njëzet e katër) vjetësh burgim”. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 319, datë 18.07.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 234, datë 14.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-346 (58), datë 27.02.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 319, datë 18.07.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

5. Në datën 18.07.2025 kërkuesi, i përfaqësuar nga avokati A.Ç., sipas aktit të përfaqësimit, ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 234, datë 14.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 319, datë 18.07.2019 të Gjykatës së Apelit të Vlorë dhe nr. 00-2025-346 (58), datë 27.02.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (*kërkesa nr. 24 (B) e vitit 2025*).

6. Në lidhje me këtë ankim kushtetues, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 248, datë 03.10.2025, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak se nuk plotësonte kriteret ligjore (*vendimi nr. 248/2025*).

7. Po ashtu, rezulton se në datën 12.09.2025, kërkuesi, i përfaqësuar nga avokatët Ndue Pjetra dhe Koldjan Reçi, ka paraqitur një tjetër ankim kushtetues në Gjykatë (objekt i këtij gjykimi), me të njëjtin objekt të kërkesës nr. 24 (B) të vitit 2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi** ka pretenduar se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të:

8.1. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmbush kërkesat për një vendim të arsyetuar, për shkak se nuk është

shprehur për kërkesat për pavlefshmërinë e akteve procedurale. Ai vendim është absurd dhe alogjik. Gjykata e Lartë, në arsyetimin e vendimit të saj, mban një qëndrim formal, pa u thelluar në pasojën që sjell shkelja e procedurës në cilësinë e provës. Ajo nuk ka bërë një analizë të plotë të çështjes në drejtim të ligjit procedural dhe material dhe ka përdorur indicien pa mbështetje të fortë shkencore ose të pavarur, në përputhje me ligjin procedural.

8.2. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi gjykatat e kanë paragjykuar kërkuesin si autor të kryerjes së veprës penale. Gjykatat i kanë bazuar vendimet e tyre në supozime dhe jo mbi prova të drejtpërdrejta. Vendimet janë bazuar mbi deklaratat e viktimave dhe dëshmitarëve, pa analizuar provat e tjera dhe pa dhënë një siguri absolute për fajësinë e kërkuesit, duke qenë se gjatë gjykimit dëshmitarët e mohojnë fajësinë e kërkuesit.

8.3. *Parimit të barazisë së armëve*, pasi gjykatat u kanë dhënë prioritet provave të paraqitura nga organi i akuzës, të cilat janë analizuar me detaje, ndërkohë nuk u kanë dhënë të njëjtën rëndësi provave të paraqitura nga mbrojtja e kërkuesit. Gjykatat janë mbështetur vetëm në provat e paraqitura nga organi i akuzës. Kërkuesi nuk ka pasur mundësi për të kundërshtuar metodologjinë e identifikimit, për të paraqitur kundërprova ose për të kërkuar përjashtimin e aktit hetimor të titulluar “njohje” si të pavlefshëm.

8.4. *Mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme dhe parimit të sigurisë juridike*, pasi kërkuesi është dënuar vetëm mbi bazën e një prove të vetme, e cila është dokumenti më i rëndësishëm i çështjes, mbi bazën e të cilit bazohet kazusi penal dhe fillimi i çështjes penale ndaj kërkuesit. Veprimi hetimor procedural i titulluar “njohje” nuk ka statusin e një prove të vlefshme në kuptim të neneve 7 dhe 175 të KPP-së. Nga vendimet e gjykatave rezulton se ky veprim hetimor është përdorur si provë themelore për të mbështetur fajësinë e kërkuesit. Në rastin konkret, veprimi hetimor i titulluar “njohje” nuk ka respektuar nenet 171 dhe 172 të KPP-së.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1,

shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në shtesë të kriterëve të pranueshmërisë, rregullimet e veçanta për shqyrtimin e kërkesave përcaktohen nga neni 31/a, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000. Ato kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës, legjitimitimin formal të kërkuarit dhe të përfaqësuesit, si dhe me respektimin dhe vlerën e vendimmarrjeve të mëparshme të Gjykatës. Një prej kriterëve që përcakton kufijtë e juridiksionit të Gjykatës parashikohet nga shkronja “dh” e pikës 2 të nenit 31/a të këtij ligji, sipas së cilës kur kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës, vendoset moskalimi i çështjes në seancë plenare. Ky rregull ligjor synon të garantojë sigurinë juridike, duke parandaluar kërkesat për rishqyrtimin e vendimmarrjes së mëparshme të Gjykatës nga të njëjtët kërkuar, për të njëjtat fakte dhe për të njëjtat pretendime.

11. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar kuptimin formal e procedural të parimit të ndalimit *res iudicata*, gjësë së gjykuar, qoftë në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ashtu edhe të fuqisë së tij detyruese. Sipas saj, tipar karakteristik i gjësë së gjykuar është se kur në vendimin e parë çështja e ngritur është konsideruar e pabazuar në themel, ajo nuk mund të shqyrtohet më tej (*shih vendimet nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 21, datë 29.04.2010; nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata në praktikën e saj ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës të të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2000, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 9, datë 07.02.2017; nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Duke mbajtur në konsideratë që i njëjti kërkuar i është drejtuar edhe më parë Gjykatës, me të njëjtin objekt kërkesë, Kolegji në vijim do të verifikojë, paraprakisht, nëse plotësohet kriteri i përcaktuar nga neni 31/a, pika 2, shkronja “dh”, i ligjit nr. 8577/2000, pra nëse pretendimet e ngritura në kërkesën për shqyrtim i janë nënshtruar më parë kontrollit kushtetues dhe përbëjnë “*gjë të gjykuar*”.

14. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Kolegji vëren se në rastin e kërkesës së mëparshme të kërkuarit me nr. 24 (B) të vitit 2025, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 248/2025, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak se nuk plotësonte kriteret ligjore. Për rrjedhojë, vendimi në fjalë është përfundimtar.

15. Po ashtu, Kolegji konstaton se në rastin e kërkesës së mëparshme të kërkuarit, për të cilën Kolegji i Gjykatës ka dhënë vendimin nr. 248/2025, kërkuari, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e: i) *parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, për shkak se ai është dënuar vetëm mbi bazën e një prove të vetme, siç është njohja, që është një akt i pavlefshëm, pasi është kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe kushtetuese; ii) *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi kërkuari është vënë në pozita të pabarabarta me organin e akuzës, së cilës i është dhënë mundësia të paraqesë pretendimet dhe provat pa iu nënshtruar një verifikimi thelbësor në lidhje me mënyrën e marrjes së tyre dhe gjykatat nuk e kanë lejuar kërkuarin të pohojë dhe të prapësojë për çdo fakt ose element provues të rëndësishëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes; iii) *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi arsyetimi i bërë nga Kolegji Penal, por edhe ai i gjykatave më të ulëta është i pamjaftueshëm, i paqartë, si dhe ka kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë, duke mos përmbushur kështu standardet kushtetuese për arsyetimin.

16. Ndërkohë, në kërkesën nr. 28 (B) të vitit 2025, objekt i këtij gjykimi, referuar së njëjtës situatë faktike, Kolegji vëren se kërkuari nuk ka ngritur asnjë argument ose shkak të ri në mbështetje të këtyre pretendimeve.

17. Nisur nga sa më sipër, Kolegji çmon se në kushtet kur jemi para të njëjtit kërkuar, për të njëjtat fakte, të cilat kanë qenë objekt i vendimit të mëparshëm të Gjykatës (vendimi nr. 248/2025), pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të paraqitura me kërkesën nr. 28 (B) të vitit 2025, në rastin konkret, nuk mund të merren në shqyrtim përderisa jemi para “*gjësë së gjykuar*”.

18. Po ashtu, Kolegji konstaton se kërkuari në kërkesën nr. 28 (B) të vitit 2025, objekt i këtij gjykimi, ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, të cilin e ka ngritur edhe në kërkesën nr. 24 (B) të vitit 2025, por në rastin në shqyrtim ka paraqitur argumente të ndryshme nga ato të paraqitura më parë. Në rastin objekt shqyrtimi (kërkesa nr. 28 (B) e vitit 2025), sipas kërkuarit gjykatat u kanë dhënë prioritet provave të paraqitura nga organi i akuzës, të cilat janë analizuar me detaje, ndërkohë nuk u kanë dhënë të njëjtën rëndësi provave të paraqitura nga mbrojtja e tij. Po ashtu, kërkuari ka argumentuar se gjykatat janë mbështetur vetëm në provat e paraqitura nga organi i akuzës dhe ai nuk ka pasur mundësi për

të kundërshtuar metodologjinë e identifikimit, për të paraqitur kundërprova ose për të kërkuar përjashtimin e aktit hetimor të titulluar “njohje” si të pavlefshëm.

19. Parimi i prezumimit të pafajësisë parashikohet në nenin 30 të Kushtetutës, sipas të cilit kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim në jurisprudencën kushtetuese është elaboruar në drejtim të faktit se gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, referuar vendimeve gjyqësore të kundërshtuara nga kërkuesi, Kolegji vëren se gjykatat e zakonshme vendimmarrjen e tyre për fajësinë e tij për veprat penale “Vrasja me dashje në rrethana të tjera cilësuese”, të mbetur në tentativë dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” nuk janë bazuar në veprimin hetimor të titulluar “njohje”, por në provat e tjera të administruara dhe shqyrtuara në seancë gjyqësore, siç janë procesverbalet për kallëzimin e veprës penale nga personat e dëmtuar, procesverbalet për marrjen e të dhënave nga personat që kanë dijeni për veprën penale, procesverbalet për sekuestrimin e provave materiale, aktet e ekspertimit balistik, akti ekspertimit mjeko-ligjor etj, të cilat janë vlerësuar si prova nga gjykatat në raport me njëra-tjetrën.

21. Konkretisht, në shqyrtimin e çështjes nga gjykata e shkallës së parë, kjo e fundit ka marrë në shqyrtim edhe pretendimin e kërkuesit për pavlefshmërinë e aktit hetimor të titulluar “njohje”. Në vendimin e saj gjykata e shkallës së parë ka evidentuar se njohja e kryer nga Policia Gjyqësore nuk është njohje në kuptim të neneve 172-175 të KPP-së, por një veprim procedural me qëllim identifikimin e të dyshuarit për vijimin e veprimeve të tjera hetimore (*shih faqen 11 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*).

22. Çështja në vijim është shqyrtuar nga gjykata e apelit, e cila ka vlerësuar sërish se veprimi hetimor i quajtur “njohje” nuk përbën provë në kuptim të nenit 149 të KPP-së, por indicie, e cila vlerësohet në raport me të gjitha provat e tjera (*shih faqen 8 të vendimit të gjykatës*). Edhe sipas asaj gjykate, pretendimet e kërkuesit për pavlefshmërinë e aktit hetimor të titulluar “njohje” nuk qëndronin.

23. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në shqyrtimin e rekursit të kërkuesit ka vlerësuar se gjykata e apelit, komplementuese e vendimmarrjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë,

ka respektuar standardin e arsytimit të vendimeve, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të të gjykuarit në përputhje me ligjin. Sipas Kolegjit Penal, vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Vlorë, për sa i përket cilësimit juridik të faktit penal të atribuuar të gjykuarit, analizës së faktit, provave ku bazohet fajësia e të gjykuarit dhe arsytimit mbi shkaqet e rekursit, është në përputhje me përcaktimet e nenit 152 e vijues të KPP-së. Në lidhje me pretendimet për pavlefshmërinë e akteve, për procedurën e njohjes dhe zgjatjen e afatit hetimor, Kolegji Penal ka vlerësuar se Gjykata e Apelit Vlorë u ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve, të cilat vlerësohen të drejta dhe të bazuara në ligj. Për sa i përket procedurës së njohjes me fotografi, sipas Kolegjit Penal, rezulton se KPP-ja nuk shprehet taksativisht për këtë procedurë, por në rastin konkret duhet të respektohen, për sa është e mundur, parashikimet e nenit 171 të KPP-së. Ndërkohë, në rastin konkret, Kolegji Penal ka vlerësuar se ndodhej procedurës së njohjes me fotografi, pasi të dëmtuarit nga vepra penale e kanë njohur edhe më parë të gjykuarin. Po ashtu, sipas Kolegjit Penal veprimi hetimor i titulluar “njohje” nuk përbën provë në kuptim të nenit 149 të KPP-së, por ka pasur si qëllim vetëm identifikimin e personit të dyshuar si autor të mundshëm të veprës penale, në mënyrë që të vijohej me veprimet e tjera hetimore. Në përfundim, Kolegji Penal ka vlerësuar se nga analiza e vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit Vlorë nuk rezulton që nga kjo gjykatë të jetë zbatuar gabim ligji material ose procedural penal, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; nuk konstatohet mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; nuk rezulton që vendimi i ankimuar të vijë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafët 18-26 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

24. Në analizë të vendimmarrjeve të gjykatave të zakonshme, Kolegji konstaton se ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, gjykatat e zakonshme kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave. Ato nuk u kanë dhënë prioritet provave të paraqitura nga organi i akuzës, nuk kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuesi dhe nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme. Po ashtu, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, referuar edhe akteve të dosjes gjyqësore, Kolegji vëren se gjykatat nuk janë mbështetur vetëm në provat e paraqitura nga organi i akuzës, por kërkuesit i është dhënë mundësia që, në kushte të barabarta me organin e akuzës, të parashtrojë pretendimet dhe të kundërshtojë akuzat e ngritura ndaj tij dhe provat mbi të cilat janë ngritur këto akuza, të paraqesë prova, të debatojë në lidhje me to e të marrë në pyetje dëshmitarët. Kërkuesit i është dhënë mundësia që të kundërshtojë edhe veprimin hetimor të titulluar “njohje”, për të cilin ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat. Gjykatat e faktit kanë arritur në përfundimin se kërkuesi ishte autor i veprave penale “Vrasja me dashje në rrethana të tjera

cilësuese”, të mbetur në tentativë dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, pa i dhënë ndonjëherë prej provave të shqyrtuara vlerë të paracaktuar. Ato kanë arritur në përfundimin për fajësinë e kërkuarit, pasi kanë kryer një proces të shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të administruara në gjykim, duke mos arritur në një konkluzion *apriori* për fajësinë e tij dhe duke e përcaktuar atë tej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe arsyetuar mjaftueshëm në këtë drejtim. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i haptazi i pabazuar.

25. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

26.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “dh” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.